

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikadur®-32 EF

AGJENT EPOKSID ME 2 PËRBËRËS PËR NGJITJE STRUKTURORE



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikadur®-32 EF është agjent për ngjitje strukturore tolerues i lagështisë me 2 përbërës, me bazë kombinimin e rrëshirave epokside dhe lëndëve mbushëse (filler) të posaçme, që përdoret në temperatura midis +10°C dhe +30°C.

PËRDORIMET

Si agjent për ngjitje strukturore dhe adeziv për:

- Elemente betoni (përfshihet ngjitja e betonit të freskët me betonin e ngurtësuar)
- Gur i fortë natyror
- Qeramika, çimento me fibra
- Llaç, tulla, mure
- Çelik, hekur, alumin
- Dru
- Poliester / fibra qelqi dhe materiale rrëshire epokside
- Qelq

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

Sikadur®-32 EF ka avantazhet e mëposhtme:

- Përzierje dhe aplikim i thjeshtë
- Ndërkapje e mirë mbi shumë materiale ndërtimi
- Rezistencë e lartë e ngjitjes
- Ngurtësohet pa tkurrje
- Përbërës me ngjyra të ndryshme (kontroll i përzierjes)
- Nuk nevojitet prajmer
- Rezistencë e lartë mekanike fillestare & përfundimtare
- I papërshkueshëm nga lëngjet dhe avujt e ujit
- Rezistencë kimike e mirë

MIRATIME / STANDARDE

- Agjent për ngjitje strukturore i testuar sipas EN 1504-4 dhe mbart shenjën CE

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshirë epokside	
Ambalazhi	1 kg (A+B)	Ambalazh gati për përdorim
	4.5 kg (A+B)	Ambalazh gati për përdorim
	10 kg (A+B)	Ambalazh gati për përdorim
Ngjyra	Përbërësi A: gri e lehtë, përbërësi B: gri e errët Përbërësit A+B të përzierë: gri betoni	
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të pahapur në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga rrezatimi drejtpërdrejtë diellor.	
Dendësia	1.5 ± 0.1 kg/l (përbërësit A+B të përzierë) (në +23 °C)	

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes			(ASTM D 695-95)
		+10 °C	+23 °C	+30 °C	
	1 ditë	~5 N/mm ²	~35 N/mm ²	~49 N/mm ²	
	3 ditë	~40 N/mm ²	~42 N/mm ²	~55 N/mm ²	
	7 ditë	~45 N/mm ²	~48 N/mm ²	~57 N/mm ²	
14 ditë	~51 N/mm ²	~52 N/mm ²	~58 N/mm ²		
Moduli i elasticitetit në ngjeshje	~ 3 300 N/mm ² (14 ditë në +23 °C)			(ASTM D 695-95)	
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes			(DIN EN ISO 178)
		+10 °C	+23 °C	+30 °C	
	1 ditë	~13 N/mm ²	~18 N/mm ²	~31 N/mm ²	
	3 ditë	~35 N/mm ²	~37 N/mm ²	~36 N/mm ²	
	7 ditë	~41 N/mm ²	~40 N/mm ²	~39 N/mm ²	
14 ditë	~50 N/mm ²	~42 N/mm ²	~40 N/mm ²		
Moduli i elasticitetit në përkulje	~ 3 700 N/mm ² (14 ditë në +23 °C)			(DIN EN ISO 178)	
Rezistenca ndaj tërheqjes	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes			(ISO 527)
		+10 °C	+23 °C	+30 °C	
	1 ditë	~10 N/mm ²	~16 N/mm ²	~18 N/mm ²	
	3 ditë	~28 N/mm ²	~30 N/mm ²	~31 N/mm ²	
	7 ditë	~34 N/mm ²	~36 N/mm ²	~30 N/mm ²	
14 ditë	~38 N/mm ²	~35 N/mm ²	~32 N/mm ²		
Moduli i elasticitetit në tërheqje	~ 3 800 N/mm ² (14 ditë në +23 °C)			(ISO 527)	
Zgjatimi deri në thyerje	1.3 ± 0.1 % (14 ditë në +23 °C)			(ISO 527)	
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	Koha e tharjes	Nënshtresa	Temp. e tharjes	Rezistenca e ndërkapjes	(EN ISO 4624, EN 1542, EN 12188)
	7 ditë	Beton i lagësht	+10 °C	> 3 N/mm ² *	
	7 ditë	Çelik	+25 °C	~20 N/mm ²	
*100% dështim betoni					
Tkurrja	Ngurtësohet pa tkurrje.				
Koeficienti i zgjerimit termik	8.7 × 10 ⁻⁵ 1/K (Shkallë temperature +23 °C – +60 °C)			(EN 1770)	
Temperatura e shformimit termoplastik	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes	Temperatura e shformimit termoplastik		(ASTM D 648)
			7 ditë	+23 °C	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 1 : 2 të peshës ose vëllimit
Konsumimi	~ 1.3 kg/m ² për mm trashësie.
Trashësia e shtresës	~ 1 mm max.
Rrjedha e varjes	Nuk varet mbi sipërfaqe vertikale deri në ~1 mm trashësi. (EN 1799)
Temperatura e produktit	Sikadur®-32 EF duhet të aplikohet në temperatura midis +10°C dhe +30°C
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.

Pika e vesës	Kujdes kondensimin. Temperatura e nënshtresës gjatë aplikimit duhet të jetë të paktën 3 °C mbi pikën e vesës.		
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min. / +30 °C max.		
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	Nënshtresa duhet të jetë e thatë ose e lagësht mat (pa pellg uji) Lyni nënshtresën me adeziv duke përdorur një furçë		
Koha e punueshmërisë	Temperatura	Koha e punueshmërisë*	Koha e punës (EN ISO 9514) (EN 12189)
	+10°C	~ 120 minuta	~ 150 minuta
	+23°C	~ 45 minuta	~ 90 minuta
	+30°C	~ 34 minuta	~ 60 minuta
	*200 g Koha e punueshmërisë fillon pas përzierjes së rrëshirës me forcuesin. Është e shkurtër në temperatura të larta dhe më e gjatë në temperatura të ulëta. Sa më e madhe të jetë sasia e përzierës, aq më e shkurtër është koha e punueshmërisë. Për të përfutur kohë më të gjatë punueshmërie në temperatura të larta, adezivi i përzierë mund të ndahet në pjesë. Një metodë tjetër është të ftohen përbërësit A+B përpara përzierjes së tyre (jo nën +5 °C).		

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Llaçi dhe betoni i ngurtësuar duhet të kenë moshë më të madhe se 28 ditë (në varësi të çdo kërkesë për rezistencë minimale).

Verifikoni rezistencën e nënshtresës me testim (beton, mur, gur natyror).

Sipërfaqja e nënshtresës (të gjitha llojet) duhet të jetë e pastër, e thatë ose e lagësht mat (pa pellg uji) dhe pa kontaminues si pislëku, vaji, graso, trajtimet ekzistuese të sipërfaqes dhe veshjet, etj.

Nënshtresat prej çeliku duhet të pastrohen nga ndryshku deri në një gjendje të ngjashme me Sa 2.5. Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme dhe të gjitha grimcat e lira duhet të hiqen.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Betoni, llaçi, guri dhe tullat

Betoni dhe nënshtresat e tjera minerale të ngurtësuar duhet të përgatiten me mjete të përshtatshme si me curril uji në presion të lartë dhe / ose pastrim me fryrje, për të përfutur sipërfaqe që janë të qëndrueshme, të pastra, të thata ose mat të lagështa (pa pellg uji) dhe pa kore çimentoje, akull, graso, vajra, veshje të vjetra apo trajtime të tjera të sipërfaqes. Çdo grimcë e lirë apo e shkrifët duhet të hiqet gjithashtu për të arritur një sipërfaqe pa kontaminime dhe me teksturë të hapur.

Çeliku

Sipërfaqet prej çeliku duhet të pastrohen dhe të përgatiten plotësisht deri në standardin e pranueshëm i cili është ekuivalent me Sa 2.5 p.sh. zakonisht me pastrim me fryrje dhe më pas largimi i pluhurit me fshesë thithëse. Te shmangen kushtet e pikës së vesës.

PËRZIERJA

Ambalazhe gati për përdorim:

Përzieni përbërësit A+B për të paktën 3 minuta me një përzierës elektrik në shpejtësi të ulët (~300 rpm) derisa materiali të bëhet me konsistencë të lëmuar dhe me ngjyrë gri të njëtrajtshme. Shmangni hyrjen e ajrit ndërsa jeni duke përzierë. Pastaj, hidhni të gjithë

përzierjen brenda një konteneri të pastër dhe përzieni sërish edhe për ~1 minutë në shpejtësi të ulët për të patur sa më pak bllokim ajri. Përzieni vetëm atë sasi që mund të përdoret brenda kohës së saj të punës.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Aplikoni Sikadur®-32 EF e përzierë mbi sipërfaqen e përgatitur me furçë, rul, spërkatje ose me mallë dhe siguroni një mbulim të njëtrajtshëm dhe të plotë. Mbi nënshtresat e ngurtësuar të betonit të përgatitura mekanikisht për të pritur betonin e freskët, aplikoni gjithmonë me furçë dhe punojeni materialin mirë mbi nënshtresë.

Vendosni betonin e freskët ndërsa shtresa e Sikadur®-32 EF është ende e 'ngjytshme'. Nëse materiali bëhet i shkëlqyeshëm dhe humbet ngjytshmërinë, aplikoni një shtresë të freskët me Sikadur®-32 EF shtesë dhe vazhdoni.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Sika® Colma Cleaner menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / maturuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

Rrëshirat Sikadur® janë formuluar për të patur zvarrje të ulët nën ngarkesë të përhershme. Megjithatë, për shkak të sjelljes së zvarrjes të të gjitha materialeve polimere nën ngarkesë, ngarkesa afatgjatë duhet të jetë shumë më e lehtë sesa ngarkesa e dështimit. Kontaktoni me shërbimin teknik Sika për informacione specifike.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikadur®-32 EF
Prill 2019, Botimi 02.01
020204030010000145

Sikadur-32EF-sq-AL-(04-2019)-2-1.pdf